

Çka do të thotë sot në botën e globalizuar socialdemokracia?
Ç'është demokracia sociale?

A është i mjaftueshëm interesimi i qytetarëve për politikë?
A mund të ngjallet serish interesimi i tillë?

A janë kompatible dinamika ekonomike dhe drejtësia sociale?
Cilat politika konkrete janë treguar të aplikueshme?

Sa kanë qenë ato të suksesshme?

Këto dhe pyetjet e tjera janë të rëndësishme në të gjitha rajonet e botës. Përmes editimit të publikimit "**Forumi demokracia sociale – vizionet dhe opsionet për Evropën Juglindore**" Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich-Ebert-Stiftung) dëshiron të jap kontributin e vet në debatin që zhvillohet në Evropën Juglindore në këtë temë. Publikimet do të përcillen nga forumi në internet (www.forum-social-democracy.org). I ftojme të gjithë lexuesit të marrin pjesë aktive në këto debate.

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Beograd
Simina 1
11000 Beograd
Serbi dhe Mali i Zi

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Sarajevë
Sumbula Avde 7
71000 Sarajevë
Bosnjë dhe Hercegovinë

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Zagreb
Prashka 8
10000 Zagreb
Kroaci

- Teksti del edhe në gjuhën maqedone, shqipe, bullgare dhe rumune.
- Të gjitha tekstet mund të gjenden në internet, në www.fes.org.yu

Programatika socialdemokrate pas zgjerimit të Unionit Euopian

Demokracisë stabile i duhet e drejta demokratike dhe alternativa e majtë demokratike

Edhe pse demokratizimi është caku i proceseve transformuese në Europën Lindore ish-komuniste, kushtet stabilizuese të demokracisë së aftë për të funksionuar përmendën relativisht rrallë. Për këtë, vendet demokratike botërore me popullatë të lartë si SHBA-të, India, Britania e Madhe dhe Franca që nga Republika e V, ofrojnë shembuj të mirë: ato janë sisteme stabile dy-partiake gjegjësisht sisteme me blloqe që dallohen qartë politikisht në mes vete. Stabiliteti i tyre qëndron në faktin që ndërrimi i qeverisë mundësohet përmes votimeve, duke mos humbur partia më pak e fortë mundësitë që të fitojë në zgjidhjet e ardhshme. Për këtë arsye, në Europë ka vlefshmëri të posaçme orientimi i përgjithshëm i alternativave politike në mes të djathtës demokratike dhe të majtës demokratike; Me sa duket edhe Demokratët dhe Republikanët në SHBA, si dhe Baratiya Janata hindu-nacionaliste dhe Partia e Kongresit në Indi, përputhen me këtë shembull alternativë.

Ndërrimi demokratik në mes të djathtës dhe të majtës është vështirësuar në shtetet tek të cilat partitë nuk veprojnë përbrenda kësaj alternative demokratike të majtë dhe të djathtë. Kjo vlenë posaçërisht në ato raste kur

- Partitë janë të orientuara në përkatësinë etnike,
- Partitë shkaktojnë dyshime sa i përket orientimit të tyre elementar demokratik

Për tu hapur ndaj demokratizimit, është e rëndësishme që të silltet vendimi për të votuar në mes të partive jodemokratike qeverisëse dhe opozitës

demokratike. Nëse një opozitë demokratike, në fitim e sipër, nuk ngritë një alternativë të rrjedhshme të djathtë dhe të majtë, atëherë do të mbetet alternativa e partive demokratike dhe jo demokratike, e cila sjell rrezikun e destabilizimit të marrëdhënieve demokratike nëse partitë jo-demokratike fitojnë në votime. Kjo problematikë shprehet në Serbi pas përfundimit të luftës në Kosovë. Është posaçërisht e rëndësishme gjatë proceseve të transformacionit që partitë demokratike të kërkojnë mundësi për integrimin e votuesëve dhe anëtarëve të pa-diskredituar të partive jo-demokratike nga sistemi i shuar. Kjo mund të mësohet edhe nga të majtit po edhe të djathtit nga shembujt si ai i Spanjës pas vdekjes së Francos dhe Polonisë pas përfundimit të pushtetit komunist.

Krijimi i një alternative të majtë-djathtë mvarret shumë nga e drejta e votimit. E drejta e shumicës votuese do ta përkrahte një gjë të tillë, ndërsa e drejta për zgjedhje proporcionale favorizon një sistem shumëpartiak. Klauzolat minimale shpjen deri te koncentrimi i partive të vogla, dhe në anën tjetër ndikojnë pas zgjedhjeve edhe në proceset e shkëmbimit në sistemet partiake, d.m.th. zhdukjen gjegjësisht krijimin e partive më të vogla. Duke u mvarur nga rezultatet e zgjedhjeve, blloqet alternative i qëndrojnë përballë vendimeve strategjike për bashkëdyzime partiake apo koalicione afatgjate. Me këtë, partitë e vogla dhe të veçanta mund të bëhen promotore të ndryshimeve, ashtu siç ishte rasti me FDP-në në Gjermani më 1962 dhe 1982, një herë nga e djathta në të majtën, pastaj nga e majta në të djathtë.



Europës post-komuniste i duhet program i majtë për integrime sociale

Procesi transformues tek shtetet Europiane që deri në vitin 1989 ishin komuniste, kishte tri qëllime:

- Të drejtat e njeriut gjegj. liritë qytetare
- Një sistem të tregut ekonomik, sistem eficient ekonomik,
- Pavarësinë kombëtare nga Bashkimi Sovjetik (Rusia) si dhe nga shtetet shumëkombëshe të konsideruara si artificiale, siç ishte raste me ish-Jugosllavinë dhe Çekoslllovakinë.

Liritë qytetare janë realizuar, vetëm po të mos ishin të rrezikuara nga konfrontimet e dhunshme etnike apo mafioze.

Një sistem i tregut ekonomik synohet dhe favorizohet përmes integrimit në UE, i cili lidhet me kërkesën për kapital të huaj.

Me përjashtim të problemeve të mbetura dhe të pazgjdhura në ish-Jugosllavi, pavarësia kombëtare është arritur dhe do të përfortohet njëkohësisht përmes integrimit në UE. Në raport me Rusinë, sa i përket aspektit të sigurisë politike, një gjë e tillë do të garantohet përmes integrimit në NATO gjegj. në strukturat e zgjëruara të bashkësisë.

Procesi i transformimit është i lidhur me pabarabartësinë e hapur sociale, varfërinë dhe disparitetet regjionale.

Përpjekjet për integrime në UE, kanë fshehur një kohë të gjatë problemet sociale dhe shoqërore. Që nga hyrja e tetë ish-shteteve komuniste me 1 maj 2004, u bë e qartë që integrimi i tyre europian nuk mund ta zavendësojë integrimin e tyre të brendshëm politiko-shoqëror.

Mekanizmat tradicional të integrimit politik në shoqërinë europiane gjegj. në shtetet e tyre, janë:

- ndarja nacionaliste kulturore nga të tjerët, apo
- strategjia e sigurisë sociale përbrenda.

Derisa në shtetet postkomuniste e djathta shfrytëzon mekanizmin nismëtar, të majtës i mungon një programatik e mjaftueshme për një integrim politiko-shoqëror e cila orientohet në siguri sociale. Për ta arritur këtë është e nevojshme të punohet në program. Vetëm kështu mund të vihet deri te një stabilitet i qëndrueshëm përbrenda shteteve anëtare të UE-së. Megjithatë, nga mesi i dekadës aktuale është bërë e qartë që duhet të sillen vendime bazë mbi të ardhmën e shtetësisë sociale në Europë.

Nëntë propozime mbi programin social demokratik në Europë në fillim të shekullit 21

Një: Programet politike i lidhin vlerat me realitetin social

Vlerat politike – qoftë mbi të drejta të njeriut qoftë kombëtare- kulturore apo socialo-integrative – konkretizohen në realitetin shoqëror përmes ra-

porteve socialo-ekonomike dhe përmes kërkesave të popullatës. Tendencia elementare e të gjitha pri-tjeve sociale bazohet në shpresën që do të bëhet më mirë, gjegj. nuk do të ketë përkeqësim. Për këtë gjë nuk ndihmojnë shumë krahasimet me gjendjen vetanake në periudhat më të hershme, mirëpo krahasimi me të tjerët, të cilët janë në gjendje më të

mirë, ndihmon shumë. Ky qëndrim "zilie" është i rëndësishëm qoftë për strategjitë e djathta kufizuese, qoftë ato të majtat integruese.

Ndikimi i qëndrueshëm i suksesit të një programi mvaret nga gadishmëria e dukshme për zhbllokim si dhe nga aftësia e partive; këtu mund të jetë përparësia e qëndrueshme e partive të majta në krahasim me ato populliste, aftësia zhbllokuese e të cilave shfaqet zakonisht shpejt.

Dy: Programet politike janë të lidhura me kohën

E vërteta mbi shoqërinë, dmth. raportet socio-ekonomike, siç është rasti me pritjet e ndër-lidhura, është pjesë e ndryshimeve historike; Për këtë arsye programet janë të lidhura me analizë kohore.

Kjo analizë kohore tregon që Europa e Mesme dhe Lindore, në dekadën e parë të shekullit 21, janë të përcaktuara nga:

- transformimi socio-ekonomik, nga një administrim qëndror i ekonomisë në një sistem të tregut ekonomik që nga viti 1989,
- transformimi politik nga pushteti komunist totalitar në sistem demokratik që nga viti 1989,
- të pavarësuarit për herë të parë të disa shteteve, pas përkatësisë shekullore në një krijesë më të madhe politike,
- ngushtë e lidhur me këtë: gjetja e identitetit shtetëror në këto vende, të cilat përmbajnë në vete minoritete të mëdha etnike/kombëtare,
- për shumicën e vendeve në regjion: anëtarësimi i vendeve (qoftë për ato që janë tashmë anëtare dhe ato që do të anëtarësohen) në UE është i lidhur me kompetencat vetanake shtetërore.

Tre: Ndarja në mes të majtës dhe të djathtës do ta orientoj politikën edhe më tutje

Programatika e partive socialdemokrate në Europë orientohet edhe më tej në alternativën majtë-djathtë. Kjo vlenë, përveç krejt diskutimeve, për "Rrugën e Tretë" apo "Mesin e Ri". Është pikërisht Anthony Giddens, këshilltari i Partisë Labour, i cili, në librin e tij "Matanë të majtës dhe të djathtës" konstaton që: "Diferencimet në të majtën dhe të djathtën...do të vazhdojnë të ekzistojnë pa dyshim në raportet praktike të politikës partiake. ... Dallimi në mes të majtës dhe të djathtës mund ta përfitojë një rëndësi thelbësore në shkëputjet nga

ambienti prozaik i politikës ortodokse? Patjetër, një rëndësi e tillë mbetet e ruajtur, nëse shiqohet nga një rrafsh i përgjithshëm. Përgjithësisht, e djathta pajtohet më tepër me praninë e pabarabartësive se sa e bënë këtë e majta, dhe ajo përkrah me më shumë dëshirë të fuqishmit se sa të pafuqishmit."

Ky dallim duhet që në politikën shoqërore ta shtyjë të majtën për integrim të shtresës së dobët dhe në parandaimin e privilegjeve. Ndërsa në politikën e saj globale në refuzimin e superfuqisë dhe në favorizimin e një rregullimi multipolar botëror.

Diferencimi i thjeshtë i Giddens, nga i cili, si pasojë, rrjedhin që të dy alternativat e vendimmarrjes politike, ndihmojnë të majtën demokratike europiane ta tejkalojë pasigurinë. Pasiguria rezulton nga dështimi dhe rënia e të majtëve komunist, e cila, vlerat si dhe termetet e të majtëve përgjithësisht, i ka diskredituar. Mesi i ri ishte një lloj kufizimi ndaj të majtës jodemokratike. Dobësia konceptuale e alternativës: "mesi" kundër së djathtës, qëndron në mosdallimin e së djathtës demokratike dhe asaj jodemokratike.

Shiquar matematikisht, mesi është pika në një drejtëz të gjatë që e ndanë të djathtën nga e majta. Praktikisht, politika e mesit nënkupton hapjen e anës alternative për zgjidhje të reja duke inkuadruar ato në anën vetanake përmes mesit. Kjo është tek partitë dy-sistemëshe (fraksionale) obligim i të majtës, por natyrisht edhe i së djathtës, posaqërisht kur të përpiqet për një shumicë në mes. Shiquar programatikisht, nuk guxon të qohet dorë nga zgjedhësit themelor të së majtës dhe duhet njëkohësisht të ngritet potenciali zgjedhor.

Katër: Politikat e majta synojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të drejta krahasuese të njeriut dhe qeverisje të depërtueshme demokratike

Vlerat e të majtës demokratike duhet të pasqyrojnë ndryshimet e formuluara nga Anthony Giddens; kjo gjenë mbështetje në vlerat si demokracia dhe drejtësia sociale. Këto vlera i referohen treshës-vlerore të revolucionit francez – Liria, barabartësia, vllazërimi. Për socialdemokracinë ndërkombëtare, dokumenti "Politika në Shoqërinë Botërore", i miratuar në kongresin e vitit 2003 të internacionalës socialiste përfiton një trihotomi të re të parimeve: Zhvillim të qëndrueshëm, të dretat e njeriut, demokraci. Çdonjëri nga këto parime ka tri dimensione. Zhvillimi i qëndrueshëm përmbanë në vete një ambient të shëndosh, përparim eko-



nomik dhe drejtësi sociale, të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtën për siguri individuale, identitet kulturor dhe integrim social, demokracia përmban qeverisje të mirë, transparencë dhe pjesëmarrje.

Kjo qasje globale e parimeve socialdemokrate në shtetet e transformuara të Europës ofrojnë orientim më të mirë se sa debatet abstrakte mbi vlerat e "perfeksionuara" të demokracive të Europës Perëndimore.

Pesë: Programi social demokratik kërkon solidaritet në mbarë UE-në

Programatika partiake, që nga fillet e demokracisë parlamentare në Europë, ofron orientim për veprimet politike të partive në shtetet nacionale. Kriteri i suksesit për këto programatika janë sukseset e zgjedhjeve në këto shtete. Me këtë rast, ka pasur gjithmonë referenca ndërkombëtare dhe europiane, pikërisht nga perspektiva kombëtare-shtetërore. Referimet globale për çdo politik janë bërë më të forta si pasojë e rënies së sistemeve komuniste në Europë dhe inovacioneve të teknologjisë informative. Mirëpo në rrafshin global ende veprojnë qeveritë, të cilat për nga programatika janë shumë pak të ndërlidhura – e njejtat gjë vlenë edhe për të majtën, pavarësisht nga përpjekjet e internacionalës socialiste për të kundërtën. Ndryshe është në rrafshin europian. Qysh prej zgjedhjeve të para të Parlamentit Europian më 1979, po ndërlidhen programatika europiane me atë të partive si dhe po rrjetëzohet edhe aftësia e tyre shkrirëse. Nëse partitë e dymbëdhjetë shteteve të para të UE janë adaptuar ngadalë me këtë aspekt, për ato vende të cilat janë anëtarësuar më 1995 ky proces do të duhej të shkonte më shpejt. Për dhjetë shtetet e reja anëtare të vitit 2004, në këtë mes edhe për Slovakinë, kjo është një eksperiencë e përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pandërmjetësuar. Risi për partitë në të gjitha 25 shtetet anëtare të UE-së është ballafaqimi me dallimet social-ekonomike në mes të shumicës së vendeve të kahmotshme anëtare dhe anëtarëve të rinj.

Programi i zgjedhor i "Party of European Socialists" i vitit 2004, përshkruan esencën e kësaj sprove. Ai përpiket për një "Union Europian, në të cilin drejtësia sociale është e ndërlidhur në vende përmes solidaritetit." Do të thotë, programi socialdemokratik në vendet anëtare të UE-së mund të kërkojë solidaritet, por duhet poashtu të jetë i gatshëm ta ofrojë po të njëjtin. Pika referuese e programit zgjedhor të SPE-së është orientimi në "modelin europian social". Për këtë ekziston formulimi më sa vijon: " për socialdomokratët euro-

pian është esenciale që UE-ja dhe vendet anëtare ti kenë prioritet standardet sociale, posaqërisht me fokus në krijimin e vendeve të çmueshme të punës, punësim të plotë, inkuadrim social, mbrojtje të ambientit dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ne duhet ta ruajmë modelin social europian me lidhshmërinë e tij në mes të zhvillimit ekonomik dhe sigurimit të kuptimtë social, si dhe forcimin dhe modernizimin e tij. Në mënyrë që të ketë një shpërndarje të mirëfilltë të mirëqenies, duhet ta forcojmë partneritetin social. Aftësia e eficiencës financiare duhet të jetë në përputhje me standardet sociale, në mënyrë që të garantohet që konkurenca e drejtë të mos dëmtohet nga "dampingu" social. Ne e shohim Unionin Europian si Bashkësi e cila mbështetet në parimet bazike të tregtisë sociale ekonomike dhe mbështetjes së ndërsjellë."

Gjashtë: Shkalla e lartë e harxhimeve publike nuk e dëmton punësimin por e krijon për më tepër drejtësi sociale, siguri dhe integrim.

Ballafaqimi vendimtar ekonomik-politik në shtetet me zhvillim më të lartë ka të bëjë me atë se si shteti me mirëqenie të lartë ndikon në zhvillim dhe punësim. Për këtë ekziston mundësia e ofrimit të dhënave të matshme, qoftë përmes kostove të përgjithshme ekonomike qoftë përmes rezultateve të tij.

Shteti europian me mirëqenie të lartë mbështetet në një shpërndarje me drejtësi problematike të produktit social në mes të sferës private dhe shtetit. Shtetit i duhet pjesa e tij, parasëgjithash për financimin e strukturës publike, për integrim social përmes arsimimit dhe për transferim të të ardhurave për ata, të cilët për arsye të moshës dhe shëndetit nuk janë në gjendje për punë konkurruese.

Aftësia vepruese e shtetit me mirëqenie mund të matet përmes daljeve të kuotave tatimore dhe të harxhimeve. Ajo qëndron mesatarisht, qoftë në UE-në e vjetër qoftë atë të zgjeruar, 40,5%. Diferenca e harxhimeve mesatare shtetërore – 48,5 përqind – qëndron në tetë pika procentuale; me këtë edhe arsyetohen defizitetet buxhetore. Është e mundur që pothuajse për të gjitha shtetet të UE-së të evidentohet një nënfinancim i obligimeve.

Në vend të parë, sa i përket të dhënave, është Suedia me 50.6 përqind, pastaj Danimarka, Belgjika dhe Franca. Irlanda qëndron me 28 përqind afërsisht njëjtë me Letlandën, Estlandën, Çekinë, Maltën, Qipron dhe Britaninë e Madhe.

Një numër më i lartë i të punësuarëve gjindet edhe në vendet me harxhime më të larta por edhe

në ato me harxhime më të ulëta shtetërore, dhe harxhime të ulëta sipas kuotave:

- në njërën anë Suedia me 50,6 përqind kuotë të harxhimeve – 74,3 përqind është shkalla e punësimit, Danimarka 48,9 përqind dhe 75,1 përqind;
- në anën tjetër Zvicërra 31,3 % dhe 77,8%, SHBA-të 28,9% dhe 71,1%, Japonia 27% dhe 68,4%, si dhe shembulli i kundërt, pra Irlanda, me 28,6 përqind dhe 56,0 përqind

Një numër i madhë i të punësuarëve është faktor i rëndësishëm i integritimit social. Megjithatë, fatkeqësisht, integrimi social lëngon edhe nga punësimi në rritje e sipër, sidomos kur puna nuk shpaguehet si duhet. Për këtë shkak, një shpërndarje e akceptueshme e të ardhurave është faktori i dytë i rëndësishëm për integrimin social. Më e volitshmja në Europë është në Danimark dhe Suedi, ndërsa me e pavolitshmja në Irland, Itali, Britani të Madhe dhe Portugali. Në të gjitha vendet e reja anëtare të UE-së është bërë qartazi e pabarabartë që nga viti 1990.

Krahasuar në mes të SHBA-ve dhe shteteve të UE-së ekziston një indikator posaqërisht drastik. Në SHBA-të ka dhjetë herë më tepër të burgosur se në Danimark dhe Suedi, apo katër herë më tepër se në Poloni, Çeki dhe Hungari në 100.000 Banor, respektivisht 470.

Si përfundim i këtyre krahasimeve ndërkom-bëtare, mund të thuhet që: harxhimet e larta shtetërore nuk janë në kundërshtim me punësimin, mirëpo ato sjellin më shumë drejtësi, siguri më të lartë sociale dhe integrim.

Shtatë: Ngritja e lartë ekonomie shkonë për shtati me shtetin aktivë dhe fuqiptotë pagues

Poashtu edhe politika ekonomike e së majtës demokratike në Sllovaki duhet të përqëndrohet në një politik të ngritjes zhvillimore – mundësisht, gjatë vitit, për më tepër se 4 përqind mesatarisht.

Përndryshe, distanca e të ardhurave e UE-15-shit është e paarritshme. Megjithatë, i nevojshëm është një diferencim më i fortë sektoral dhe regjio-nal. Është e nevojshme një paletë e gjërë e produkteve tregtare dhe shërbimeve, të cilat do të ofrohe-shin parasëgjithash nga ndërmarrjet e mesme.

Është i nevojshëm shëndërrimi i mëtutjeshëm i një ekonomie të orientuar industrialisht në një ekonomi të bazuar në dituri. Këtu qëndron përparësia e të gjitha vendeve europiane sa i përket konkuri-mit global. Ekonomia e diturisë dhe shoqëria me dituri të lartë e kenë poashtu edhe dimensionin

e vet social. Me këtë rast integrimi social pason përmes ngritjes së ndihmave më të forta për ata që janë anash në procesin e arsimimit. Kjo duhet të jetë një pikëqëndrim i fortë i të majtës demokratike. Për këtë nevojitet një shtet i aftë me mirëqenie të lartë, i cili nuk mund të jetë i tillë me një kuotë të ulët të harxhimeve. Për këtë arsye, politika ta-timore do të duhej të orientohej në ngritje të të ardhurave me më shumë drejtësi sociale.

Përmirësimi i të ardhurave është i mundur për-mes sferës së tatimit mbi të ardhurat dhe – sipas modelit të SHBA-ve- mbi katipalet bazë. Është i nveojshëm një progresion i qartë tatimor me të ardhura maksimale tatimore prej 40 përqind. Niveli tatimor qëndron në vet SHBA-të 41.8%, ndërsa në Francë, Suedi, Belgjikë, Norvegji, Finlandë, Japoni dhe Austri mbi 50 përqind, në Danimarkë madje 59 përqind. Në kontekst europian, nuk do të ishin të qëlluara ndryshimet në tatimin e përgjithshëm në vlerë të shtuar dhe tatimin mbi ndërmarrje. Drejtësia sociale do të përmirësohej përmes një uljeje të diferencuar të tatimit mbi vlerë të shtuar për të mirat e nevojave bazike si dhe një shumë të lirë dhe më të lartë të tatimeve mbi paga.

Lehtësimet tatimore nuk ndihmojnë nëse të ardhurat janë të ulëta. Për këtë do të duhej një sistem i cili shkallë për shkallë do ta harmonizon-te ngritjen e të ardhurat minimale dhe forcimin e sindikatave.

Tetë: Demokracia sociale mbronë diversitetin kulturor

Nëse integrimi social do të ketë sukses në shoqëritë e UE-së, atëherë identiteti kulturor mund ti kuptojë qytetarët e vet si të drejtë njeriu dhe një pasuri për të gjithë Europën, për një Europë të dallimeve dhe diversiteteve.

Akceptimi i të drejtave universale të njeriut është parakusht i vetëkuptueshëm global. Të drejtat e njeriut i paraprijnë identitetit kulturor dhe nuk mund të kufizohen nga vlerat kulturore – kështu janë të papranueshme të drejtat më të ulëta të nje-riut në rastin e femrave, ashtu siç propagohet nga islami. Mirëpo ka edhe konkretizime të drejtave të njeriut, dhe ato janë në Europë kërkesa minimale për drejtësi sociale dhe integritimit social.

Shteti social europian është pjesë e identitetit kulturor të Europës. Identiteti kulturor në secilin shtet të Europës nuk është i njëjtë me identitetin kombëtar. Në çdo shtet kombëtar të Europës fliten disa gjuhë, pra ka pakica. Kjo vlenë shkaku i rapor-teve qindvjeçare, kjo vlenë poashtu për emigraci-onin prej vendeve islame pas Luftës së II Botërore. Identiteti kulturor ndërlidhet me në shumë rrafshe,



gjuhësore dhe kombëtare, lokale dhe regjionale, të përkatësisë popullore, të religjionit. Identitetet kulturore mund të instrumentalizohen për përjashtimin e të tjerëve e deri te agresioni luftarak nacionalo-shtetëror. Qëllimi vendimtar dhe një e arritur e madhe e Unionit Europian është pengimi i këtij përjashtimi dhe agresioni në mes të shteteve anëtare, të drejtat për minoritete dhe mbrojtja e tyre janë konsekuencë obligative. Në UE, secili duhet të ndiej kënaqësi për identitetin e vet kulturor, pa rrezikim të të tjerëve.

Politika socialdemokratike e nënkupton si pasurim bashkëjetesën e shumicës dhe pakicave. Integrimi social i Romëve është një detyrë mbarëeuropiane. Kjo detyrë nuk mund t'i lihet shteteve si Sllovakia, Çekia, Hungaria apo Rumunia si përgjegjësi e brendshme. Vendbanimet e tashme të Romëve janë pasojë e anës së erët të historisë europiane.

Nëntë: Mbrojtja efektive Europiane ka nevojë për rregulla europiane

Shtetet, të cilat investojnë në dimensionin social të integritimit politik, mund ta arrijnë atë nëse angazhohen për shtetësi sociale në tërë UE-në. Kësaj duhet t'i paraprijnë dy vendime themelore politike:

- Për UE-në dhe të gjitha shtetet anëtare të saj, zhvillimi dhe sigurimi sociale janë qëllime me vlerë të njëjtë. Nuk vlenë thënia: zhvillimi së pari pastaj sigurimi social. Kjo nuk vlenë as për shtetet anëtare më të varfëra si Sllovakia. Politika sociale duhet të kuptohet si faktor produktiv i politikës ekonomike europiane.
- Në UE vlenë konkurrenca në mes të ndërmarrjeve dhe jo konkurrenca vendore në mes të shteteve anëtare. Kjo ka për pasojë përpjekjet politiko-ekonomike për barazimin e kornizës së kushteve dhe të ardhurave.

Duke marrë parasysh trajektorën e mirëqenies, që nga shumica e vendeve të vjetra e deri te

anëtarët e ri të UE-së, solidariteti i nivelizueshëm mund të haset parasëgjithash tek të pasurit. Janë të nevojshme fonde të mjaftueshme strukturale të UE-së, në mënyrë që të financohen parakushtet institucionale dhe infrastrukturale të zhvillimit. Kundërrrezultati i solidaritetit do të ishte të qohet dorë nga dampingu – sa i përket tatimeve dhe rrogave.

Faktor vendimtar i çrregullimit të konkurrencës në UE janë tatimet mbi ndërmarrjet. Është i nevojshëm harmonizimi i tyre mbarëeuropian. Një tatim mbi ndërmarrjet për 20 përqind është një vlerë orientuese në bazë të së cilës duhet të lëvizin shtetet anëtare. Në etapa më të gjata, të papranueshme janë dallimet drastike sa i përket fuqisë financuese të shteteve anëtare në përgjithësi. Nënfinancimi tek shtetet e reja, gjegjësisht të varfëra, nuk mund të nivelizohet përmes transferit nga të pasurit në fondet strukturale të UE-së.

Dampingu i rrogave sjell dëme në Europë për të gjithë. Pagat e ulëta u sjellin dëm punonjësëve në vendet e varfëra, pasi që vazhdojnë të jetë të varfëra më shumë se që është e nevojshme, poashtu edhe në rastin e punonjësëve në vendet e pasura, pasi që papunësia është më e lartë se që është e nevojshme. Sfidat e madhe për politikën sociale dhe për strategjinë e sindikatave në UE është barazimi i nivelit të pagave, posaqërisht në lartësi. Parakushti politiko-ekonomik është një sistem i pagave minimale në të gjitha vendet e UE-së, të cilat parasëgjithash në vendet e varfëra ku produkti social do të ishte në rritje e sipër, i përshtatur hap pas hapi.

Poashtu edhe krahasueshmëria e kualifikimeve profesionale në mes të të gjitha shteteve anëtare të UE-së pengon dampingun e pagave. Posaqërisht sa i përket nivelit të shërbimeve janë të nevojshme aftësimet adekuate, me konsekuencë të pagesës së njëjtë për aftësim të krahasueshëm.

Është një gabim i madhë dhe me pasoja të rënda paramendimi i pëfaqësuesëve të tregut-liberal, që njerëzit në shtetet ish-komuniste donin ta këmbenin adoptimin totalitar të mendimit me pa-sigurinë sociale. Siguria sociale si parakusht i lirisë personale është një ofertë e aftë për të ardhmën nga ana e të majtës demokratike të Europës.